



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.562/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Lavdërim Ismail Bahtiri me vendbanim në Gjermani, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 03.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i palejuar apeli Anr.562/2021, i datës 02.03.2021, i parashtruar nga Lavdërim Ismail Bahtiri me vendbanim në Gjermani, për mos konfirmim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që janë mbajtur më datë 14 Shkurt 2021.

A r s y e t i m

Me datë 02.03.2021, PZAP-i, ka pranuar një apel të parashtruar nga Lavdërim Ismail Bahtiri me vendbanim në Gjermani, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 04 shkurt 2021, me të cilin thekson se i është shkelur e drejta për të votuar, edhe se ka aplikuar me kohe mirëpo nuk është në listën e votuesve.

Paneli pasi që shqyrtoj lejueshmërinë e apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli, pasi që konstatoj lejueshmërinë e apelit, gjeti se apeli i parashtruar, është i palejuar për arsye se parashtruesi i apelit nuk ka paraqitur ndonjë vendim të KQZ-së, me të cilën ju është refuzuar aplikacioni për tu regjistruar në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Paneli ka parasysh faktin se ne rastin konkret nuk ekziston një vendim i KQZ-së, me të cilin do të mund të konstatohej se parashtruesi i apelit është larguar nga lista e votuesve, andaj paneli ka parasysh se bazat e Apeleve zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122, apelimet zgjedhore, paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se: Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të të cilit janë

prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja, mund të apelojë atë vendim në KZAP:

- a) Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;
- b) Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;
- c) Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;
- d) akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;
- e) vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe
- f) Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.

Andaj mbi këtë bazë Paneli vlerëson se apeli është i palejuar, nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 562/2021 më datën 03.03.2021

Kryesues i Panelit

Adnan Korushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.